

Viti shkollor 2019-2020, miratohet vendimi për tekstet shkollore falas për Diasporën

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për tekstet shkollore falas Do të përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra Botimeve për për Diasporën dhe kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Diasporën nxënësit dhe mësuesit sipas përcaktimeve të vendimit Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 – 2020. të këshillit të ministrave nr.443 datë 26.06.2019, "Për organizimin e Sipas këtij vendimi Qendra e Botimeve për Diasporën do të botojë procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë". Në dhe do të sigurojë falas për vitin shkollor 2019-2020 tekstet shkollore link-un e mëposhtëm mund të lexoni të plotë vendimin dhe listën e dhe ato plotësuese për mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë. teksteve shkollore për Diasporën për vitin shkollor 2019-2020.



Ministri në "Forumit për Bashkë-Investime dhe Rrjetëzim", në Prizren

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko mori pjesë në duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional për tërheqjen e investimeve ceremoninë e hapjes së "Forumit për Bashkë-Investime dhe të huaja dhe nga Diaspora. "Marrëveshja e lidhur në Pejë në 2018 Rrjetëzim", i cili u mbajt në qytetin e Prizrenit. Në fjalën e tij ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë ministri tha se gjatë këtyre viteve, Qeveria Shqiptare dhe ajo e së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe Kosovës kanë dhe po ndërmarrin iniciativa të rëndësishme drejt informimin e Diasporës është dëshmi e qartë e këtij vullnetit të dy qeverive, përmirësimit të mjedisit dhe klimës të biznesit në Shqipëri, për të pasur një angazhim më të madh të Diasporës", tha ministri.



Miratohet vendimi për "Organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë"




Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për "Organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë". Objekti i këtij vendimi është nxitja dhe përkrahja e organizimit të procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në vendet pritëse të Diasporës shqiptare. Sipas këtij vendimi kanë të drejtë të ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në vendet pritëse të Diasporës shqiptare fëmijet e moshës deri në 18 vjeç me kombësi shqiptare, si dhe çdo person me origjinë shqiptare që jeton në vendin pritës, pavarësisht statusit të tij, me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm, azilkërkuës, të strehuar të përkohshëm apo persona pa shtetësi. Mësimi i gjuhës shqipe do të zhvillohet në përputhje me kurrikulën e përbashkët sipas marrëveshjes midis ministrisë së arsimit dhe sportit të Republikës së Shqipërisë, ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë si dhe ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës.

Foto lajm



Shqiptarët e Karakurtit, Ukrainë në koncertin e përgatitur në përfundim të mësimave të valleve dhe këngëve tradicionale shqiptare nga artistët e Ansambllit Kombëtar Shqiptar. Ky cikël seminaresh u realizua si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit.

Publikohet numri i dytë i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit për Strategjinë Kombëtare të Diasporës



Agjencia Kombëtare për Diasporën publikon numrin e dytë të Buletinit tremujor për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2018-2024. Ky publikim, i cili përmban masat e Planit të Veprimit që janë në proces zbatimi, është një pasqyrë e plotë e punës së kryer për realizimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Të dhënat që paraqet ky publikim informojnë publikun dhe anëtarët e strukturave vendimmarrëse për ecurinë e politikës shtetërore për Diasporën. Buletini është një dokument i hapur për çdo vërejtje dhe sugjerim. Institucionet, grupet e interesit, publiku, media dhe qytetarët janë të mirëpritur për propozimet e tyre, të cilat do të shërbejnë për fuqizimin e bashkëpunimit me Diasporën.

Ministri takohet me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare izrealite "AJC"



Gjatë takimit u bisedua për shkëmbimin e përvojave të të dy vendeve. Ministri Majko e njohu delegacionin me kornizën e plotë ligjore të hartuar për Diasporën shqiptare si dhe tematikat më të shpeshta që hasen në komunitetin shqiptar në botë. Ndërsa Drejtori Ekzekutiv i AJC, z. David Harris tha se është e rëndësishme që të dyja palët të shkëmbejnë përvojat me Diasporën, pasi Diaspora izraelite është një nga më të mëdhatë në botë, ka modele të mira që mund të aplikohen në Shqipëri por nga ana tjetër edhe gabime nga të cilat mund të mësohet.